

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.61/2025	Data: 28.03.2025	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 14, paragrafi 1, neni 58 pika h) të Ligjit Nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/04 Qershor 2008), neni 14 paragrafi 1, nen paragrafi 1.1, neni 15 paragrafi 2, neni 16 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, si dhe bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës së Istogut HZK 2024-2032 pas rishqyrtimit të vendimit 00.Nr.48/2025 në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2025 mori këtë:

**VENDIM PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT 00 Nr.48/2025
PËR NDARJEN E PRONËS KOMUNALE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE QENDRORE
KORPORATA E RUAJTJES SË ENERGJISË KRE SHA.A
(Lokacioni Bellopojë)**

1. MIRATOHET -Vendimi për bartjen e pronës publike komunale nga Komuna e Istogut te Ndërmarrja Publike Qendrore Korporata e Ruajtjes së Energjisë KRE SH.A në sipërfaqe prej (50,000) m² nga njësia kadastrale me nr.P-70806003-00501-1 Zona Kadastrale në Bellopojë K, Istog ti bartet drejtpërdrejtë Korporatës së Ruajtjes së Energjisë (KRE).
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi ky projekt është i një rëndësie të veçantë për sistemin elektroenergjetik të Kosovës dhe për konsumatorët e energjisë elektrike të vendit, si i tillë konsiderohet si projekt me interes të veçantë publik.
3. Lokacioni sipas nenit 1 të këtij vendimi ka për qëllim aktivitetin e ruajtjes shume funksionale të energjisë ("Aktiviteti MFES") synon të mbështesë Ndërmarrjen Publike Qendrore, Korporata e Ruajtjes së Energjisë (KRE) sh.a për të zotëruar operuar afërsisht 125 MW (ose 250 MWH) të një sistemi të ruajtjes së energjisë përmes baterive (BESS)".Ky sistem është duke u projektuar për të ofruar rezervat e rivendosjes së frekuencës arbitrazhin e energjisë elektrike ose edhe shërbime të tjera potenciale të ruajtjes së energjisë elektrike.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdesen : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

00 Nr./Br. 033-49 Nr. i faq: Br. 01

Data/Datum 03 / 04 / 2025

ISTOG - ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit

z. Enver Rugova

E. Rugova